



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

AUDITIMI NË SHËRBBIM TË QEVERISJES SË MIRË

Roli dhe Ndikimi i ZKA-së


Prishtinë, 2025



Auditori i Përgjithshëm është institucioni më i lartë kushtetues i kontrollit ekonomik dhe financiar në Republikën e Kosovës. Mandatin dhe përgjegjësitë i ushtron në bazë të ligjit, duke qenë i pavarur në aspektin financiar, funksional, dhe operacional.

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ndihmon Auditorin e Përgjithshëm në kryerjen e detyrave. ZKA-ja i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ka të drejtë të kontrollojë të gjitha aktivitetet, programet dhe projektet financiare, administrative dhe të tjera të menaxhuara nga institucionet publike, përfshirë procesin dhe të ardhurat nga shitja e aseteve, privatizimeve dhe koncesioneve.

Përmes auditimit publik, ZKA-ja kontribuon në menaxhimin e shëndoshë të buxhetit të shtetit, rrit besimin në shpenzimin e parasë publike, siguron interesin e taksapaguesve, si dhe promovon standarde të larta për transparencë dhe llogaridhënie të administratës shtetërore.





VIZIONI

Institucion Suprem i Auditimit i besueshëm dhe model që i shton vlerë përdorimit të fondeve publike.



MISIONI

Nëpërmjet auditimeve cilësore ofrojmë siguri në shfrytëzimin e pasurive dhe parasë publike, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarë dhe rritjen e llogaridhënies publike.



VLERAT



Pavarësia



Transparenca



Integriteti



Fryma Ekipore



Profesionalizmi

RRETH NESH

Struktura organizative e ZKA-së pasqyron ndarjen e qartë të përgjegjësiave dhe siguron funksionim të pavarur dhe efikas. Puna dhe kontributi i stafit vlerësohen si shtylla kryesore e suksesit në realizimin e mandatit kushtetues dhe ligjor.

Nga 171 të punësuar:



JANË AUDITORË



PUNONJËS TË SHËRBIMEVE PROFESIONALE
MBËSHTETËSE NË AUDITIM

83.5% e të punësuarve auditorë kanë çertifikime sipas skemave profesionale, kurse rreth **75%** e të gjithë të punësuarve ndjekin trajnime specifike dhe të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në baza vjetore.



57%

Gjinia femërore



43%

Gjinia mashkullore


Mosha mesatare

43 VITE



Vlora Spanca

Auditore e Përgjithshme
e Republikës së Kosovës



MESAZHI I AUDITORES SË PËRGJITHSHME

Një shoqëri e fortë dhe e qëndrueshme ndërtohet mbi themelet e besimit, drejtësisë dhe transparencës, në veçanti kur bëhet fjalë për shpenzimin e parasë publike. Mbi këto parime udhëhiqet Zyra Kombëtare e Auditimit.

Çdo euro e parasë publike duhet të menaxhohet me kujdesin më të lartë nga institucionet publike dhe çdokush tjetër që përdor atë. Kjo është pjesë e përditshmërisë tuaj: në shkolla ku mësojnë fëmijët tanë, në spitale ku kujdesen për shëndetin e të afërmeve tanë, në rrugë, në punë, në shtëpi e kudo që shteti ofron shërbime për qytetarët tanë.

Auditimet tona nuk janë vetëm numra, informata apo raporte, por fuqi që vazhdimisht ndihmojnë dhe nxisin për ndryshim. Pas çdo gjetjeje dhe rekomandimi që japim, qëndron një mundësi për të ndërtuar institucione më të ndershme, shërbime më cilësore dhe një të ardhme më të sigurt për brezat që vijnë.

Vizioni ynë është i qartë: të forcojmë besimin tuaj te qeverisja e institucioneve të shtetit tonë dhe të mbrojmë me përkushtim interesin publik. Sepse vetëm kur ndërtojmë mbi baza të shëndosha, të ndershme e të drejta mund të ndërtojmë të ardhmen që të gjithë e duam.

Së bashku mund të sjellim ndryshimet që i duam, ta çojmë vendin tonë atje ku e meriton, drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe mirëqenies për çdo qytetar.

LLOJET E AUDITIMIT

1

AUDITIME FINANCIARE DHE TË PAJTUESHMËRISË

Vlerësojnë nëse pasqyrat financiare ofrojnë pamje të drejtë dhe të saktë në të gjitha aspektet materiale, si dhe nëse proceset dhe transaksionet janë kryer në përputhje me kornizën ligjore.

2

AUDITIME TË PAJTUESHMËRISË

Vlerësojnë nëse veprimet, transaksionet dhe vendimet janë zhvilluar në përputhje me kornizën ligjore.

3

AUDITIME TË PERFORMANCËS

Vlerësojnë nëse programet dhe aktivitetet publike realizohen në mënyrë efektive, efikase dhe ekonomike.

AUDITIMET E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Vlerësojnë nëse sistemet e teknologjisë së informacionit dhe kontrollet përkatëse kanë siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomisë, dhe efektivitetit.

FAZAT E AUDITIMIT



Faza 1
Planifikimi



Faza 2
Ekzekutimi




Faza 3
Raportimi



Faza 4
Përcjellja

REZULTATET E PUNËS AUDITUESE



NDIKIMI I PUNËS AUDITUESE

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) jep kontribut të rëndësishëm në forcimin e qeverisjes, transparencës dhe menaxhimit të përgjegjshëm të fondeve publike. Rezultatet e auditimit kanë ndikuar në:



Përmirësim të menaxhimit të pasurisë publike



Rritje e saktësisë në raportimin financiar



Forcim i transparencës dhe llogaridhënies



Qeverisje e mirë

Rastet e raportuara ndër vite te organet e drejtësisë, Prokurori i Shtetit:

2024 56 raste

2023 51 raste dhe 2 raporte auditimi

2022 77 raste


BASHKËPUNIMI

ZKA-ja është ndër institucionet më të besueshme dhe me ndikim në vend dhe jep kontribut aktiv në arenën ndërkombëtare, si anëtare e **INTOSAI** dhe **EUROSAI**.


Përmes bashkëpunimit me palët e interesit dhe partnerët e saj vendor si: Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe institucionet tjera shtetërore, qytetarët, mediat dhe shoqëria civile, kontribuon në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë.

Në kuadër të bashkëpunimit afatgjatë dhe të frytshëm ndërkombëtar, bilateral dhe multilateral, kontribuon në nisma zhvillimore dhe promovon zbatimin e standardeve më të larta të auditimit publik.

EUROSAI
INTOSAI



HISTORIKU



ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT E KOSOVËS

2003

- Themelimi i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

2008

- Institucioni i Auditorit të Përgjithshëm integrohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Miratohet Ligji nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës.

2020

- Zyra Kombëtare e Auditimit bëhet pjesë e organizatave ndërkombëtare INTOSAI dhe EUROSAL.

Dixhitalizohet procesi i punës audituese – Lansimi i Sistemit elektronik për Menaxhimin e Auditimit – SITA.

2003 - 2005

Inga-Britt Ahlenius
Auditore e Përgjithshme

2006 - 2008

Linda Casella
Auditore e Përgjithshme

2009 - 2014


Lage Olofsson
Auditor i Përgjithshëm

2016 - 2021

Besnik Osmani
Auditor i Përgjithshëm

2021 - AKTUALISHT

Vlora Spanca
Auditore e Përgjithshme





Ky botim është përgatitur nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës. Të gjitha të dhënat dhe informacionet janë pronë e ZKA-së dhe mund të përdoren vetëm duke cituar burimin. ZKA ushtron aktivitetin e saj në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.



**TRANSPARENCË
LLOGARIDHËNIE
BESIM**